



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2014

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi e thelluar

Shekspiri

Jul Qezari

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	C	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	A	1 pikë

Pyetja 6 3 pikë

Qëllimi:

- Mark Antoni e përdor fjalimin e tij për të ngritur turmën kundër komplotistëve.

*Analiza e plotë*

- Ai e bën këtë duke u përqendruar në të mirat e Qezarit dhe nuk thotë asgjë të keqe për komplotistët. Mark Antoni e njeh natyrën e njerëzve. Ai është në gjendje të ngacmojë emocionet e njerëzve (jo arsytet e tyre). Ai e bën turmën t'i vijë keq për të, duke i kujtuar se Qezari ishte miku i tij, ishte i besës. Mark Antoni bën që turma të ndihet fajtoare, duke i treguar se Qezari qante për të varfrit. Mark Antoni e kthen turmën kundër komplotistëve duke mohuar ambicien e tij. Gjithashtu, ai shkakton urrejtje të turma duke treguar plagët në trupin e Qezarit, të cilat ia shkaktuan ata që ai iu besonte.

*Analiza e pjesshme*

- Mark Antoni kërkon ta kthejë turmën e qytetarëve kundër komplotistëve duke synuar emocionet e njerëzve.
- Mark Antoni bën që njerëzit të besojnë në të mirat që bënte Qezari.

**1 pikë** Nëse tregon *qëllimin* e fjalimit të Mark Antonit.

**DHE**

**2 pikë** Nëse analizon në mënyrë *të plotë* se si e bën ai këtë.

**OSE**

**1 pikë** Nëse analizon në mënyrë *të pjesshme* se si e bën ai këtë.

**0 pikë** Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 7**                      **2 pikë****Shembujt**

- Në vend që të kërkonte pushtet, Qezari e hodhi tri herë poshtë kurorën mbretërore;
- Në vend që të kujdesej për pasurinë e tij, Qezari i solli Romës robër lufte dhe shumë pasuri;
- Në vend që të mendonte për veten, Qezari shqetësohej (qante) për të varfrit.

**2 pikë**                      Nëse identifikon (me vargje ose fjalë) dy nga shembujt e sjellë nga Mark Antoni.

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse identifikon (me vargje ose fjalë) vetëm një shembull.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 8**                      **2 pikë****Përshtypja:**

- Lehtësisht e manipulueshme.

**Shpjegimi:**

- Në fillim turma është e bindur se Qezari e meritonte të vritej, por pas fjalëve ndikuese, emocionuese të Mark Antonit ajo fillon të lëkundet, derisa në fund kalon në urrejtje ndaj komplotistëve dhe ndien keqardhje për Qezarin.

**OSE**

- Turma ndikohet emocionalisht nga fjalët e Mark Antonit. Janë njerëz që udhëhiqen nga ndjenja dhe jo arsyeja. Mark Antoni e di këtë dhe pikërisht këtu e orienton fjalimin e tij, duke bërë që turma e qytetarëve të ndryshojë ndjenjat nga simpati për komplotistë në urrejtje për ta.

**1 pikë**                      Nëse tregon përshtypjen që krijon Shekspiri në lidhje me karakterin e turmës.

**1 pikë**                      Nëse shpjegon përgjigjen e dhënë.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 9**                      **3 pikë**

- **Toni: ironik**

- **Analiza e plotë**

- Në fillim duket se Mark Antoni i referohet në mënyrë të sinqertë figurës së Brutit me shprehjen “i nderçim”, por ndërsa e përsërit disa herë përgjatë fjalimit, ajo fillon dhe merr një ngarkesë tjetër emocionale. Duke shprehur dashurinë e tij për Qezarin, kjo fjalë mbart zemërimin e Mark Antonit për vrasësit përmes ironisë, pra thotë diçka por nënkupton tërësisht diçka tjetër.

- **Analiza e pjesshme**

- Me fjalët që thotë Mark Antoni nënkupton diçka tjetër.

**1 pikë**                      Nëse tregon tonin që përdor Bruti.

**DHE**

**2 pikë**                      Nëse analizon në mënyrë *të plotë* funksionin e përdorimit.

**1 pikë**                      Nëse analizon në mënyrë *të pjesshme* funksionin e përdorimit.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 10 (a) 1 pikë**

- Mark Antoni kërkon ta kthejë turmën përfundimisht në anën e vet dhe përmendja e testamentit (dhjatës) është prova e fundit e fortë për të bërë kthesën përfundimtare të turmës. Ai e ofron atë pikërisht në momentin kur turma është lëkundur në ndjenjat e saj për Qezarin dhe po dyshon seriozisht tek komplotistët.

**1 pikë** Nëse tregon arsyen përmendjes së testamentit.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 10 (b) 1 pikë**

- Ky fjalim është i rëndësishëm pasi shënon edhe pikën kthesës për të gjithë tragjedinë. Është pikërisht momenti kur për shkak të gabimit fatal që bën Brutit (duke e lënë Mark Antonin të flasë vetëm para turmës), Antoni me fjalët e tij bindëse e kthen turmën kundër komplotistëve, duke marrë përfundimisht kontrollin e situatës në duart e tij, gjë që sjell edhe shkatërrimin e Brutit dhe të të tjerëve.

**1 pikë** Nëse tregon pse ky fjalim është i rëndësishëm.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 11 6 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË 2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku argumenton se njeriu mund ta drejtojë vetë jetën e vet apo gjithçka është çështje fati.
- përdor detaje mbështetëse të marra nga vepra apo përvoja;
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË 1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI 2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE 1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.

## Ismail Kadare

## Kronikë në gur

Pyetja 12	A	1 pikë
Pyetja 13	C	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	B	1 pikë
Pyetja 16	A	1 pikë

## Pyetja 17                    2 pikë

- Personazhi kryesor është qyteti.
- Vetëm për të flitet nga fillimi deri në fund të fragmentit.

1 pikë                    Nëse tregon personazhin kryesor.

**DHE**

1 pikë                    Nëse shpjegon pse pikërisht qyteti.

0 pikë                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 18                    2 pikë

**Arsyet:**

- Kjo përmendje thekson idenë e lashtësisë së këtij qyteti, që në kohën e Perandorisë Romake;
- Jetën e vështirë që ai kishte pasur, përmes luftërave, pushtimet që e kishin shoqëruar përgjatë gjithë historisë. Qëndresa në shekuj, stoicizmi i këtij qyteti.

2 pikë                    Nëse gjen dy nga arsyet e përmendjes së perandorive.

1 pikë                    Nëse gjen vetëm një arsye.

0 pikë                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

## Pyetja 19 (a)                2 pikë

➤ **Analiza e plotë**

- Për këtë qytet flitet si të ishte personazh i gjallë, që mendon, çohet, ndjen, vështron me mospërfillje, përbuz. Ai fiton karakteristika si: gri, i vetmuar, i braktisur. Në fakt janë cilësi të banorëve, që i mbart qyteti. Ai personifikohet apo metonimizohet, njëjtësohet me banorët e vet.
- Rrëfimi behët nga sytë e fëmijës, ndaj është mjaft emocionues, figurativ, tërheqës, ku mbizotëron fantazia, figurat.

➤ **Analiza e pjesshme**

- Përshkrimi është emocionues dhe figurativ.

2 pikë                    Nëse analizon në mënyrë *të plotë* mënyrën se si përshkruhet qyteti.

1 pikë                    Nëse analizon në mënyrë *të pjesshme* mënyrën se si përshkruhet qyteti.

0 pikë                    Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 19 (b) 2 pikë**

➤ Ngjyra gri në vetvete është një ngjyrë e ftohtë dhe që shkakton ndjesi mërzie, vetmie, ftohtësie. Në këtë fragment ajo përcjell pikërisht këto ndjesi: ftohtësi, ashpërsi, akullsi. Është kjo pamja që ky qytet i vjetër iu ofron pushtuesve të tij të fundit: ngurtësinë e tij, boshësinë e tij, akullsinë e tij, mungesën e jetës dhe gëzimit.

**➤ Interpretimi i pjesshëm**

➤ Nënkupton të ftohtën të akulltën

**2 pikë** Nëse zberthen në mënyrë *të plotë* nëntekstin që mbart ngjyra gri.

**1 pikë** Nëse zberthen në mënyrë *të pjesshme* nëntekstin që mbart ngjyra gri.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 19 (c) 2 pikë****Përshkrimi real:**

- Bombardimi vazhdoi tri orë.
- Ato ndaluan në xhade dhe vetëm tytat e gjata të topave u rrotulluan ngadalë drejt qytetit.
- Pararoja u godit me pushkë dhe me bomba.
- Tanket nuk u futën në qytet.

**Përshkrimi figurativ:**

- Xhadeja nxinte prej tyre.
- Ishte një bombardim i rëndë, monoton.
- Zhurma e ndeshjes së hekurit me gurin, mbushi gjithë luginën.
- Copëra muresh e çatish, gjymtyrë ndërtesash e koka oxhaqesh, fluturonin nga të gjitha anët.
- Një pluhur i zi po mbulonte çdo gjë

**1 pikë** Nëse gjen një rast të përshkrimit real.

**DHE**

**1 pikë** Nëse gjen një rast të përshkrimit figurativ.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 20 2 pikë****Interpretimi i plotë**

➤ I gjithë dialogu përmban sa doza vërtetësie po aq dhe një nëntekst të hollë ironik. Plakat janë kujtesa e këtij qyteti. Ato kanë parë shumë dhe e dinë si vijnë dhe ikin pushtuesit, ndërsa qyteti vazhdon të mbetet aty, i gurtë dhe i lashtë. Ato dinë se pushtuesit vijnë me zhurmë, po ikin të mundur dhe pa lavdi.

Plaka e jetës përcjell një përvojë të tërë, të trashëguar brez pas brezi. Ajo është urtësia, përvoja, vetë filozofia e këtij populli për jetën.

**Interpretimi i pjesshëm**

- Plakat përcjellin një përvojë;
- Dialogu midis plakave tregon fatin e pushtuesve.

**2 pikë** Nëse interpreton në mënyrë *të plotë* dialogun midis plakave.

**1 pikë** Nëse interpreton në mënyrë *të pjesshme* dialogun midis plakave.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*